



Imagination
Ideas Inspiration
Innovation

Negotiation
Networking
Novelties
Necessities

Coordination
Concepts

Advocacy
Achievements
Aspirations
Answers



www.inca-al.org

Nr. 55

Viti i pestë i botimit

Dhjetor 2017

Në këtë numër do të gjeni:

- ...me këtë rast Ju kujtojmë se...
- Sistemi i Monitorimit të faunës së Egër (AKZM-SIMF)
- Miqësor me mjedisin, nëse e duam jetën, të ardhmen e fëmijëve tanë / Nga L.Kondi
- Reagime të forta kundër HEC-ve në Valbonë
- Çelet Faza e Dytë e Projektit të PNUD-it
- Bashkëbisedime me grupet e interesit për problematikën e menaxhimit dhe identifikimin e impakteve negative në Parqet Kombëtare
- Qendër për rehabilitimin e arinjve; ministri Klosi dhe de Biasi mbështesin nismën
- Identifikimi i ndikimeve negative në zonat e mbrojtura dhe problematikat e menaxhimit të burimeve natyrore të tyre / nga Shoqata ILIRIA
- Mbyllet projekti i ACHIEVE
- Procesi Kombëtar i Monitorimit të Biodiversitetit dhe Roli i Komunitetit Akademik/Shkencor
- Si e përmirëson pjesëmarrja publike vendimmarrjen për çështjet mjedisore?
- Nivelet e rrezikshme të mërkurit / nga Qendra EDEN
- Kuriozitete - Njoftime

... me këtë rast Ju kujtojmë se
22 vjet më parë ...

...me Urdhër të Ministrisë së Bujqësisë nr.2,

dt.26.12.1995, territori lagunor, pyjet aluvional dhe pjesë e dunave ranore të Rrushkullit-Rrotull, me sipërfaqe 650 ha, ri shpallet Rezervat Gjuetie, i shpallur

Vijon në faqe 2



Peisazhi i Mbrojtur Ujor-Tokësor i Pogradecit © Foto INCA



Institute for Nature Conservation in Albania
Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri

Vijon në faqe 4 për herë të parë në dt. 07.07.1956, me sipërfaqe 1286 ha. Me udhër nr.404, dt. 25.01.1983, sipërfaqja e rezervatit të Rrushkull-Rrotull zvogëlohet në 700 ha, duke hequr sipërfaqen e Rrotullës. Pas miratimit të ligjit për Zonat e Mbrojtura ky rezervat u njehësuar me statusin, sipas IUCN, "Rezervat Natyror i Menaxhuar". Gjendja është

...9 vjet më parë ...

...me VKM nr.1631, dt.17.12.2008, ekosistemi natyror-malor i Bredhit të Hotovës-Dangëlli, me sipërfaqe 34,361.1 ha, shpallet Park Kombëtar me sipërfaqe të zëjruar, pasi në të u përfshi dhe territori, kryesisht bredhishtja, me sipërfaqe prej 4200 ha i "Bredhit të Hotovës", i shpallur park kombëtar, me VKM nr. 102, datë 15.01.1996. Për këtë park kombëtar, me mbështetje të IPA10, nëpërmjet projektit SELEA, është hartuar dhe Plani i Menaxhimit, i cili deri më sot nuk ka gjetur zbatim. Me shqetësuese për menexhimin e parkut është ndërtimi i HEC-ve, veçanërisht ai mbi lumin e Langanicës, i cili cënon rëndë kanionin dhe ujërat termale të Bënjës.

...15 vjet më parë ...

...me VKM nr.676, dt.20.12.2002, shpallen "ZONË E MBROJTUR" 750 njësi Bio dhe Gjeo Monumente të Natyrës Shqiptare...

...6 vjet më parë ...

...me VKM nr.898, dt.21.12.2011, ekosistemi natyror-malor i Korab-Koritnikut, me sipërfaqe 55,550.2 ha, të shtrirë në qarkun e Dibrës dhe të Kukësit, shpallet "Park Natyror". Me mbështetje të IPA10, nëpërmjet projektit SELEA, është hartuar dhe Plani i Menaxhimit, i cili deri më sot nuk ka gjetur zbatim. Me shqetësuese për menexhimin e parkut është ndërtimi i HEC-ve, veçanërisht mbi lumin e Lumës dhe të Radomirës.

AKZM me strukturat e saj të vartësisë, ka detyrë dhe duhet të jetë e kujdesshme që të evidentojnë dhe të marrin masa për kremtimin me dinjitet të këtyre datave historike, duke hapur një faqe të re në punën e tyre, për njohjen dhe promovimin e zonave të mbrojtura, duke bashkëpunuar ngushtë me institucionet dhe shoqërinë civile.

Sistemi i Monitorimit të faunës së Egër (AKZM-SiMF)

Nëntor 2017 - Prespë, Pogradec, Shkodër - Në kuadër të Projektit CSBL (Projekti i Tre Liqeneve) i financuar nga GIZ, një grup ekspertesh janë duke punuar për krijimin e një platforme monitorimi për disa specie të përzgjedhura të faunës së egër për tre liqenet, Prespë, Ohri, dhe Shkodra. Në këtë kuadër INCA

u angazhua dhe realizoi një proces trajnimi mbi aplikimin e kësaj skeme monitorimi me stafet përkatëse pranë AdRZM-ve respektive. Trajnimet u zhvilluan pëgjatë muajit Nëntor me rangers-at e Parkut Kombëtar të Prespës, ato të Peisazhit të Mbrojtur Ujor-Tokësor të Pogradecit si dhe me rangers-at e Rezervatit

Natyror të Menaxhuar të Liqenit të Shkodrës. Trajnimi ishte dy ditor dhe i kombinuar mes informacionit teorik dhe aplikimit të tij në praktikë në terrenin e zonave të mbrojtura.

Programi i trajnimit asistoi stafet e AdRZM-ve për planifikimin dhe realizimin e procesit të monitorimit përmes ngritjes dhe funksionimit të patrullave monitoruese si dhe ndihmoi në regjistrimin e të dhënave sipas AKZM-SiMF.





Miqësor me mjedisin, nëse e duam jetën, të ardhmen e fëmijëve tanë

nga L.Kondi / Shoqëria Civile.com

Telefonata më erdhi atëherë kur duhej. Kisha kohë që mendoja se sa të pandjeshëm ishim ndaj gjithçkaje, por kjo thirrje më bëri të reflektoj. Sa shumë nevojë ndjeja të ndaja me dikë eksperiencën, njohuritë, por të mësoja edhe më rreth përpjekjeve që bënte për të na ndërgjegjsuar një shoqatë miqësore me mjedisin. U grisha të shihja me sytë e mi se dikush nuk po rri duarkryq, por është aktiv për të mirën e mjedisit ku jetojmë të pasur dhe të varfër, qeveritarë dhe të papushtet, mendjemëdhenj dhe të përlurur. Njësoj jetojmë të shëndetshëm apo barabar vdesim në të.

Mjedisi është jeta jonë...

Më kishin ftuar në një tryezë me kolegë, të hershëm e të rinj, për diskutuar e marrë njohuri për atë që po i bëjmë vetë mjedisit. Me dorë tonë po e "vrasim". Me zhvillimin, urbanizimin dhe ndërtimet pa kriter, prerjen dhe djegien e mijëra hektarëve pyje, me hidrocentralet që si kuçedra në përrallën e gjyshes përpijnë pa mëshirë lumenj, e me gjithçka tjetër pjell fantzia, çmenduria jonë e pa fre po përgatitim funeralin e mjedisit, njëherazi tonin...

Si mud ta ndalim etjen deri në babëzi për para të atyre që i vënë shkelmin mjedisit, ekzistencës sonë dhe të tyre njëkohësisht?!

Më mungonin prej kohësh angazhime si ky, aq sa kisha një mendim të gabuar se ishim kthyer thjesht në konsumatorë të gjithçkaje, pas dashur t'ia dimë për asgjë.

...Tryeza ishte gati.

Projektori vendosur thjesht mbi tavolinë lëshonte disa "slides" mbi një tabelë të bardhë.

Një grua kishte lëshuar vështrimin mbi pjesëmarrësit për të na kërkuar gatishmërinë e fundme.

Prezantimi i saj ishte i shkurtër fare.

Emirjeta m'u bë se tha, kordinatore e Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri (INCA) që organizonte aktivitetin "Shoqëria Civile vepron për Zhvillimin Social - Ekonomik mbi Bazat e një Mjedisi të Shëndetshëm".



Përfaqësoja portalin modest "shoqëriacivile.com", i ri, por me ide të qarta në mbrojtje dhe të mirë të habitetit tonë.

Secili prezantoi median nga vinte.

Na shkonte ky aktivitet. Por, sepse ndihesha më afërv, më bëhej se më rrinte më mirë natyra e tij.

"Mjadisi është i pari". Me këtë drejtuesja na thoshte shoqëria civile dhe medias duhet ta ndjenin rolin që kanë si aktorë të pavarur, efikasë, të përgjegjshëm në mbrojtje të mjedisit. Thjesht fare nëse e duam mjedisin duhet të ndikojmë në zbatimin e procedurave të vlerësimit të ndikimit që kanë projektet,

strategjitë, programet dhe planet e veprimit kombëtar. Është përgjegjësia jonë evidentimi i mangësive apo dhe dhënia e mendimeve për përmirësimin e tyre dhe kuadrit ligjor që mundëson ato.

Secili nga, qoftë dhe i vetëm, ka të drejtë të

kërkojë transparencë për vlersimin mjedisor.

Vendet e zhvilluara dhe ato në zhvillim kanë shembuj dhe praktika të mira që duhen marrë në konsideratë.

Ndërsa këtu ndihemi se jami larg tyre dhe nuk e kuptojmë nëse kjo vjen nga indiferenca apo ngaqë edhe kur flasim nuk na dëgjojnë ata që kemi zgjedhur me vorë e paguajmë nga xhepatat tanë për të na shërbyer. Dhe ne azhdojmë të heshtim...

Ndaj INCA punon të nxisë qënrimin tonë kritik. Ky institut kërkon nga mediat, të shkruara dhe vizive, sjellje proaktive në procesin e vlerësimit të mjedisit.

INCA dëshiron pjesëmarrjen aktive të shoqërisë në proceset e diskutimeve publike për projekte dhe investime të qëndrueshme në dobi të ekonomisë dhe mjedisit, që të mos kemi përsëritjen e rasteve të zhdukjes së lumenjve, pyjeve apo dhe ndotjes së ujërave.

Po ne ç'bëjmë?!

Ejani t'i bashkohemi zërit të saj!

Bashkohuni me ne e të kujdesemi sëbashku për mjedisin nëse duam të jetojmë shëndetshëm...!

Reagime të forta kundër HEC-ve në Valbonë

Vendimi i Gjykatës Administrative për të lejuar ndërtimin e dy Hidrocentraleve në Valbonë ka nxitur reagime të forta nga ana e shoqatave ambientaliste.


Pas deklaratës së Shoqatës Toka, e cila tha se do përshkallëzojë betejën kundër hidrocentraleve, është Fondi botëror për mbrojtjen e natyrës Adria, ai që është pozicionuar fort kundër vendimit të gjykatës.

Në një deklaratë zyrtare për shtyp, WWF Adria shpreh keqardhje për vendimin e gjykatës për lejimin e ndërtimit të këtyre hidrocentraleve sepse ky zhvillim do të dëmtojë në mënyrë të konsiderueshme dhe pa kthim biodiversitetin dhe ekosistemin e kësaj zone të mbrojtur.

“Për më tepër, meqenëse vendimi për zhvillimin është bazuar në vlerësim të dobët të ndikimit në

mjedis dhe në një proces me pjesëmarrje joadekuat të publikut, kemi frikë se do të vendoset një precedent i rrezikshëm që mund të dërgoj në shkatërrimin e lumenjve dhe burimeve të ujërave të ëmbla në gjithë vendin”, tha Petra Remeta menaxhere e programit për ujërat e ëmbla në WWF Adria.

Burimi web



Çelet Faza e Dytë e Projektit të PNUD-it



Vlorë, 17 Nëntor 2017 - Në ambientet e Konsullatës Italiane në Vlorë, e zhvillua ceremonia e çelies së Fazës së Dytë të Projektit të UNDP mbi menaxhimin efektiv të zonave të mbrojtura detare për Parkun Kombëtar Detar Karaburun Sazan

Bashkëbisedime me grupet e interesit për problematikën e menaxhimit dhe identifikimin e impakteve negative në Parqet Kombëtare

Në funksion të iniciativës së Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës në Shqipëri, mbi procesin e identifikimit të aktiviteteve me impakt negativ në 16 Zona të Mbrojtura në Shqipëri, INCA zhvilloi bashkëbisedimet e rradhës me grupet e interesit për “Problematikën e menaxhimit dhe identifikimin e impakteve negative në Parqet Kombëtare “Shebenik-Jabllanicë” dhe Divjakë-Karavasta si dhe anketimin individual (plotësimi i pyetësorit). Këtë herë, së bashku me organizatat partnere të OJF-ve lokale dhe Administratat e Parqeve Kombëtare, INCA u ndal në Rrajcë dhe në Sulzotaj.

Në takime ishin të pranishëm grupet e interesit nga këto zona si bujq, fermerë, mësues, OJF lokale, peshkatarë etj. Në takime u diskutua mbi



programet dhe punën e administratave të Zonave të Mbrojtura për ruajtjen, menaxhimin dhe promovimin e vlerave të Parkqeve si dhe pati një bashkëbisedim të hapur me grupet e interesit të këtyre zonave.

Vijon në faqe 6

Vijon nga faqe 5

Ky aktivitet realizohet në kuadër të projektit “Promovimi dhe advokimi i menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve dhe vlerave natyrore në zonat e mbrojtura”, që mbështetet nga Programi SENIOR-II dhe i zbatuar nga REC Albania.



Qendër për rehabilitimin e arinjve; ministri Klosi dhe de Biasi mbështesin nismën

Tiranë 15 Nëntor 2017 - Arritje dhe sfida në dy vite përpjekje për të shpëtuar arinjtë më të trishtuar - ka qenë tema e takimit organizuar nga FOUR PAWS International ku u diskutua situata e deritanishme si dhe prezantimi i arritjeve të përbashkëta përgjatë viteve 2016-2017, gjendja aktuale e arinjve të robëruar dhe prezantimi i rezultateve të investigimit për një panoramë më të qartë për zgjidhje afatgjata dhe të qëndrueshme.

Në takim ishte i pranishëm dhe Ministri i Turizmit dhe Mjedisit, z.Klosi i cili theksoi se nisma si këto tregojnë se shoqëria civile po ecën me hapin e kohë duke reflektuar dhe ofruar zgjidhje për problemet shqetësuese të jetës sonë. Dy moratoriumet, ai i pyjeve dhe i gjuetisë kanë dhënë rezultate konkrete deri tani.

Ministri firmosi petitionin për shpëtimin e arinjve, i cili ishte nënshkruar nga mbi 400,000 njerëz nga e gjithë bota dhe dha dritën jeshile për ndërtimin e qendrës së shpëtimit dhe rehabilitimit në Shqipëri. Në përfundim të fjalës së tij, Klosi theksoi se Ministria është aleat i përhershëm i florës dhe faunës.

Mesazhi i ish-trajnerit të Kombëtares për mjedisin dhe shpëtimin e arinjve nga robëria!

“Përsëritet të gjithëve. Unë jam Gianni De Biasi. Mirëdita dhe punë të mbarë! Para së gjithash falenderoj ministrin Blendi Klosi për mbështetjen që na jep në këtë iniciativë tonën. Besoj që ky impenjim i ministrit është diçka e jashtëzakonshme dhe bëhet kështu pjesë e aksionit tonë të përbashkët në mbrojtje të mjedisit dhe veçanërisht të arinjve.

Arinjtë ashtu si të gjitha gjallesat kanë të drejtë të jetojnë në këtë planet, pa qenë të skllavëruar dhe të mbyllur në kafaz siç për fat të keq ndodh ende në Shqipëri dhe në disa vende të tjera të botës. Besoj që nevojitet angazhimi dhe kontributi i gjithësecilit nga ne për një botë më të mirë, për të mbrojtur këtë pasuri mjedisore që kemi dhe që mund të ruhet vetëm nëse të gjithë ne angazhohemi seriozisht. Unë personalisht angazhohem në këtë grupim që po jep kontributin e tij në mënyrë që të ruhet ky planet nga të shndërruarit në një botë të pabanueshme.

Ju përqafoj dhe ju falenderoj të gjithëve, ju pjesëmarrës dhe atyre që do të jenë pjesë e kësaj përpjekjeje në të ardhmen. Duhet të ngremë zërin së bashku që mjedisi është prona jonë e përbashkët dhe që duhet mbrojtur me çdo kusht.

Faleminderit edhe njëherë zoti ministër dhe ju lutem të përcillni përsëritetjet e mia më të sinqerta edhe zotit kryeministër, Edi Rama me të cilin kam një marrëdhënie të shkëlqyer dhe që është gjithmonë shumë i vëmendshëm për problemet mjedisore. Shqipëria duhet ta tregojë veten në botë si një vend të civilizuar, ashtu siç e njoh edhe unë dhe që duhet të përmirësohet në aspektin mjedisor. Një përqafim të sinqertë për të gjithë! Forca Shqipëria!”



Identifikimi i ndikimeve negative në zonat e mbrojtura dhe problematikat e menaxhimit të burimeve natyrore të tyre / nga Shoqata ILIRIA

Shoqata për zhvillim mjedisor e social "ILIRIA" si pjesë e rrjetit "Për Mbrojtjen e Natyrës" në Shqipëri po vazhdon turin e bashkë bisedimeve me grupet e interesit në territoret që përfshijnë dy zona të mbrojtura: "Parku Kombëtar Dajt" dhe Peisazhi I Mbrojtur "Mali me Gropa-Bizë-Martanesh". Deri tani janë realizuar tre takime në Zall-Bastar, Linzë dhe Shëngjergj me ndërmjetësinë e administratës së njësisë Vendore, në bashkëpunim me AdZM-Tiranë shoqatat lokale të përdorimit të pyjeve si dhe banorë e përfaqësues biznesesh.

Gjatë takimeve është realizuar dhe anketimi individual nëpërmjet pyetësorëve për evidentimin e problematikave me ndikime negative në mjedis. Të pranishmit, përfaqësues të Njësisë Vendore, shoqatës së pyjeve dhe të banorëve, shprehën shqetësim ndër të tjera dhe për mungesën e shërbimeve mjedisore për të eliminuar fenomenin e erozionit tejte i shprehur në këto zona. Menaxhimi i aktivitetit të furnizimit me dru zjarri has jo vetëm problematika të zbatimit të ligjit por edhe problematika të mospërshtatshmërisë së statusit të zonës me nevojat e banorëve.

Në këtë kuadër duhet të bëhen përpjekje që statusi i zonës së mbrojtur të mos bëhet pengesë për thithjen e investimeve për shërbime ndaj mjedisit të eroduar si pyllëzime apo prita malore, apo dhe furnizimi i popullatës vendase me dru zjarri të bëhet i kontrolluar dhe duke



marrë parasysh edhe gjëndjen ekonomike të tyre.

Të pranishmit shprehën shqetësimin për aktivitetin e pa kontrolluar të guroreve duke shkarkuar pluhur dhe për pasojë ndotjen e ajrit duke shkaktuar ulje të prodhimit të tokës përreth por edhe dëmtim të rrugëve të frymëmarrjes për banorët me vendbanim afër tyre.

Këto aktivitete do të vazhdojnë edhe në njësi të tjera të këtyre dy ZM, aktivitete që realizohen nëpërmjet projektit "Promovimi dhe advokimi i menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve dhe vlerave natyrore në Zonat e Mbrojtura" mundësuar nga Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) Shqipëri, në kuadër të programit SENIOR II i financuar nga Qeveria Suedeze

Mbyllet projekti i ACHIEVE

Tiranë 22 Nëntor 2017 - Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) Shqipëri organizoi aktivitetin



përmbyllës të projektit "Shoqëri Civile për një Mjedis Evropian - ACHIEVE", financuar nga BE dhe zbatuar nga REC Shqipëri.

Aktiviteti ishte konceptuar jo vetëm si përmbyllje dhe shpalosje e rezultateve të këtij projekti, por edhe si një bashkëbisedim mes organizatave të shoqërisë civile përfituese nga projekti në lidhje me sfidat kryesore që ka shoqëria civile dhe kush mund të jenë hapat e mëtejshëm që duhen ndërmarrë nga shoqëria civile dhe nga mbështetësit e saj për përmirësimin e gjëndjes.

Z. Mihallaq Qirjo, Drejtor i REC Shqipëri theksoi se roli i shoqërisë civile në zhvillimin dhe maturimin e mëtejshëm të

Vijon në faqe 8

Vijon nga faqe 7

demokracisë në Shqipëri është jo vetëm i domosdoshëm por edhe i pashmangshëm. NdoDh shpesh që organizatat e shoqërisë civile ndeshen me mosreagimin e institucioneve shtetërore, mosdhënien e informacionit të nevojshëm apo edhe presione të ndryshme për të hequr dorë nga kauzat e tyre. Përmes programit ACHIEVE dhe një sërë programesh të tjera të ngjashme, REC ka mbështetur që zëri i tyre të jetë i fortë, i organizuar dhe më profesional.

Menaxheri i projektit ACHIEVE, z. Rezart Kapedani u ndal në rezultatet e përgjithshme të projektit. Pavarësisht vështirësive që kishte fillimi i projektit si një projekt risi në mbështetjen e shoqërisë, ai i arriti pritshmëritë e tij. Ka pasur një përfshirje shumë të mirë të shoqërisë civile (145 OSHC të përfshira) dhe 39 organizata kanë përfituar mbështetje

financiare për zbatimin e aktiviteteve të tyre. Po ashtu OSHC-të kanë arritur që të hartojnë analiza të mirëfillta të boshllëqeve të legjislacionit, monitorime në praktikë të zbatimit të tij dhe shumë aktivitete që përfshijnë komunitetin, të rinjtë dhe vënien në praktikë të ideve të reja. 20 aktivitete për rritjen e kapaciteteve janë organizuar nga REC Shqipëri për përfituesit e programit.

Në lidhje me çështjet e të ardhmes, në katër tryeza të rrumbullakëta, përfituesit dhe kontribuesit e projektit diskutuan rreth përmirësimit të bashkëpunimit të OSHC-ve me autoritetet shtetërore (qeveria qendrore dhe vendore), mungesën e ekspertizës së OSHC-ve mjedisore, përfshirjen e OSHC-ve të vogla në çështjet rajonale dhe programet kombëtare dhe qëndrueshmërisë së OMSHC-ve dhe lidhjen e tyre me komunitetin vendor.

Burimi - Mjedisi Sot

Procesi Kombëtar i Monitorimit të Biodiversitetit dhe Roli i Komunitetit Akademik/Shkencor

Tiranë 30 Nëntor 2017 - Nëkuadër të projektit "Konservimi dhe Përdorimi i Qëndrueshëm i Biodiversitetit në Liqenet e Prespës, Ohrit dhe Shkodrës" (CSBL). i financuar nga GIZ, INCA organizoi në Tiranë Takimin Bashkëpunues "Procesi Kombëtar i Monitorimit të Biodiversitetit dhe Roli i Komunitetit Akademik/Shkencor".

Qëllimi i takimit ishte prezantimi i gjithë procesit të nisur për ngritjen e Sistemit të Monitorimit të Biodiversitetit nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura e njohur si AKZM-SiMF dhe BIONNA. Takimi pati si objekt propozimin e mënyrave për përfshirjen e komunitetit akademik shkencor në përdorimin e këtij sistemi, si një mjet standard për grumbullimin e të dhënave në monitorimin e biodiversitetit, për të unifikuar mënyrën e grumbullimit dhe përpunimit



të këtyre të dhënave në një bazë të përbashkët me atë të AKZM dhe MTM.

Takimi synoi promovimin e rezultateve kryesore të sistemeve të monitorimit, duke ofruar gjetjen dhe propozimin e mënyrave për përfshirjen e kontributit të komunitetit akademik shkencor në këtë proces, si një domosdoshmëri dhe pjesë e rëndësishme e aktorëve të kuadrit kombëtar institucional. Ai shërbeu si një kuvend

diskutimesh dhe debatesh me fokus institucionalizimin e rolit dhe kontributit të komunitetit shkencor përmes përdorimit të metodologjisë dhe formateve standarde, të cilat duhet të përcaktohen nga

ana e MTM si detyrime ligjore për realizimin e SiMF, BIONNA apo mjeteve të tjera të standardizuara të monitorimit të biodiversitetit.

Si e përmirëson pjesëmarrja publike vendimmarrjen për çështjet mjedisore?



CO-SEED

*Fragmente nga manuali i praktikave
më të mira botërore*

Shteti: Zelandë e Re

Rasti: Përmirësimi i Autostradës Shtetërore 2

Theksi: Shumëllojshmëria e informacioneve të përdorura për të siguruar akses transparent në informacion.

Autoriteti Krugor Transit New Zealand (TNZ), planifikoi ndërtimin e një segmenti në Autostradën Shtetërore 2 nga Kaitoke në TeMarua. U krahasuan katër mundësi për ndërtimin e autostradës, duke synuar përzgjedhjen e asaj me ndikimin më të ulët në mjedis dhe komunitetet përfaqëse.

Procesi i konsultimit publik ishte gjithëpërfshirës dhe i shumëllojshëm, ku u përdorën gjithsej 14 teknika të ndryshme për të siguruar akses të plotë dhe transparent në informacion dhe pjesëmarrje publike. Këto përfshinin:

- Letra dhe telefonata të gjithë pronarëve të pronave pranë segmentit të autostradës nën studim që mund të preken.
- Mbledhje tradicionale të organizuara me pronarët e identifikuar të tokave dhe indigjenët Maori që preken në mënyrë të drejtpërdrejtë. Gjithashtu, u organizuan mbledhje shtesë me autoritetet vendore/rajonale. Gjatë këtyre

mbledhjeve u ofruan paketa informacioni.

• Banorëve të prekur iu dërguan tre buletinë informativë ku informoheshin për procesin dhe gjendjen e projektit.

• U dhanë deklarata për shtyp në mënyrë që të synohej informimi i një audience më të gjerë, të cilët përndryshe nuk do të ishin në dijeni të propozimeve.

• U mbajt një mbledhje jozyrtare ku morën pjesë rreth 60 veta dhe u ofrua informacion rreth projektit, si dhe u treguan imazhe të planeve ajrore për alternativat e propozuara. Pyetjeve iu përgjigjën anëtarët e ekipit të projektit dhe një përfaqësues i TNZ-së.

• Në librarinë publike të komunitetit vendas u vendos një stendë ku paraqiteshin imazhe të drejtimeve të propozuara (në bazë të planeve ajrore).

Pjesa më e madhe e teknikave të përdorura ofronin një qarkullim informacioni njëdrejtimësh. Megjithatë, mbledhjet publike kishin karakter dydrejtimësh ku individët mund të jepnin reagimin e tyre gjatë diskutimit. Përqejësia për ofrimin e informacionit dhe konsultimeve gjithëpërfshirëse binte mbi autoritetin publik përkatës, i cili u ndihmua edhe nga kompania konsulente.

Nivelet e rrezikshme të mërkurit

nga Qendra EDEN

Studimi i ri zbulon nivelet e rrezikshme të mërkurit në gratë e moshës riprodhuese në të gjithë botën <http://ipen.org/mercury-and-women>

(Goteborg, Suedi) Mërkuri, një metal neurotoksik, është gjetur në nivele të larta në të gjitha rajonet botërore në gratë e moshës riprodhuese, sipas një studimi të kryer nga IPEN (rrjeti global i shëndetit publik dhe mjedisit) dhe Instituti i Kërkimeve të Biodiversitetit (BRI). Gratë në ishujt e Paqësorit dhe në komunitetet pranë zonave të minierave të arit në Indonezi, Kenia dhe Mianmar u gjetën të kenë nivele mesatare të mërkurit shumë herë më të larta se sa nivelet e këshilluara për shëndetin sipas Agjencisë Amerikane të Mbrojtjes së Mjedisit (EPA).

Hulumtimi, Mërkuri në Gratë e Moshës Riprodhuese në 25 Vende, u ndërmor për të matur prevalencën e mërkurit në peshën trupore në nivele që mund të shkaktojnë dëme neurologjike dhe organike. Mërkuri në trupin e nënës mund të transferohet në fetusin e saj gjatë shtatzënisë, duke e ekspozuar zhvillimin e fetusit tek neurotoksina e fuqishme. Ky studim është i pari i këtij lloji për të përzgjedhur sa më shumë vende dhe rajone dhe duke vënë në qendër të vëmendjes gratë e moshës riprodhuese.

Hulumtuesit nga IPEN koordinuan marrjen e mostrave të flokëve nga 1044 gra të moshës riprodhuese në 37 vende shpërndarë në 25 shtete në 6 kontinente. Analizat kryera nga BRI, zbuluan se 36% e grave të marra në kampionim kishin nivele mesatare

Vijon në faqe 10

Vijon nga faqe 9

të mërkurit mbi nivelin e këshilluar për shëndetin sipas EPA që është 1ppm, mbi të cilat mund të ndodhin dëmtime të trurit, humbje të IQ, dëmtim të veshkave si dhe dëmtime kardiovaskulare. Studimi zbuloi gjithashtu se 53% e mostrës globale të femrave kishin nivel të mërkurit shumë se 0.58ppm, një nivel i lidhur me fillimin e dëmtimit neurologjik të fetusit.

Studimi zbuloi ndjeshëm rritjen e përqendrimeve të mërkurit në flokë të grave në shumë rajone të botës lidhur me tre shkaqet mbizotëruese të ndotjes së mërkurit: termocentralet me qymyr (një nga burimet kryesore globale që ndot oqeanet me mërkur i cili grumbullohet në peshq), miniera ari artizanale në shkallë të vogël (ASGM) dhe vendet e ndotura lokale nga industritë e ndryshme që lëshojnë mërkur në tokë, ujë dhe ajër.

Gjetjet kryesore:

- Në ishujt e Paqësorit, i cili është larg nga të gjitha burimet industriale të mërkurit, por ku njerëzit konsumojnë peshk si burim primar të ushqimit, 85.7% kanë tejkaluar kufirin prej 1 ppm, ku shumica e grave maten tre herë më shumë se standardi amerikan i EPA.
- Më tepër se gjysma e grave të kampionuara në Indonezi, Kenia, Mianmar dhe Paraguai treguan nivel mërkuri mbi 1 ppm në komunitetet të cilat jetojnë në saj të minierave të arit. Duke përjashtuar Paraguain, ku peshku nuk është lëndë e parë e proteinave, 81% e grave treguan nivel mbi 1ppm, ndërsa gratë në dy vende të Indonezisë treguan nivele të mërkurit mes tre dhe nëntë herë më shumë se standart i lejuar sipas Agjencisë Amerikane të Mbrojtjes së Mjedisit.
- Një në pesë gra në komunitetet e studiara pranë zonave të industrializuara kanë nivele mërkuri mbi 1 ppm. Kjo përfshin gratë në Nepal, Nigeri dhe Tajlandë, ku vendet e ndotura ndotin tokën, ujrat dhe burimet ushqimore. Përveç kësaj, gratë pranë vendeve të ndotura në Shqipëri, Kili, Kazakistan, Nepal dhe Ukrainë treguan nivele mesatare mbi 0.58ppm.

"Ky studim ilustron kërcënimin global të ndotjes së mërkurit për gratë dhe fëmijët e shumë kombeve të ishullit të Paqësorit dhe për shumicën e grave të përfshira në minierat artizanale të arit në shkallë të vogël", tha Lee Bell, hulumtuesi kryesor i studimit nga IPEN. "Nivelet shumë të larta të mërkurit që gjenden në flokët e shumicës së këtyre grave tregojnë

për nevojën urgjente për veprim për të çrrënjësuar termocentralet me qymyr dhe tregtinë ndërkombëtare të mërkurit që furnizon minierat e artë në shkallë të vogël, dy shkaqet më të rëndësishme të ndotjes nga mërkuri".

Në mujin Shtator, qeveritë nga e gjithë bota u mbledhën në Gjenevë, Zvicër për të diskutuar hapat e ardhshëm për traktatin e ri ndërkombëtar, ligjërisht të detyrueshëm, Konventën e Minamatës mbi Mërkurin. Hulumtimi nënvizoi nevojën për udhëzime për të identifikuar vendet e ndotura me mërkur, për të monitoruar mërkurin në peshën trupore dhe për të ndërmarrë veprime për të kufizuar burimet primare të ndotjes së mërkurit - termocentralet me qymyr dhe Minierat artizanale të arit/ASGM.

Yuyun Ismawati, Udhëheqëse e IPEN për Minierat e arit /ASGM dhe fituesja e çmimit Goldman, komentoi: "Milionë gra dhe fëmijë në komunitetet pranë minierave të arit me mërkur janë dënuar me një të ardhme ku mërkuri dëmton shëndetin e të rriturve dhe dëmton trurin e zhvillimit të pasardhësve të tyre. Për sa kohë që vazhdon tregtia me mërkur, gjithashtu do të vazhdojë edhe tragjedia e mërkurit."

Ky studim nënvizon rëndësinë e bashkëpunimit global për të adresuar ndotjen e mërkurit", tha Dr.David Evers, Drejtor Ekzekutiv dhe Drejtues i kërkimit shkencor në BRI si dhe bashkëautor i studimit. "Ndotja e Mërkurit është e kudogjendur në sistemet detare dhe në ujërat e ëmbla nëpër botë. Pikat e nxehta biologjike të mërkurit janë globalisht të zakonshme dhe lidhen me një sërë aktivitatesh njerëzore. Për këto arsye, është e rëndësishme që ne të vazhdojmë përpjekjet e biomonitorimit për të përcjell ndikimet e mundshme në komunitetet lokale dhe mbi mjedisin në mënyrë që të vlerësojmë efektivitetin e Konventës së Minamatës".

Banorja i Ishujve Cook, Imogen Ingram e Aleancës për Qëndrueshmërinë e Ishullit mësoi se nivelet e saj të mërkurit ishin dy herë e gjysmë më shumë se standardi i këshilluar për shëndetin sipas Agjencisë Amerikane të Mbrojtjes së Mjedisit. "Është me të vërtetë alarmante të mësohet se ke nivele të larta të mërkurit toksik në trupin tënd dhe si rezultat, ti pa e ditur, i ke kaluar fëmijës tënd mërkur", komentoi ajo. "Ndotja me mërkur në Ishujt e Paqësorit është e lartë, sepse konsumojmë peshq, por unë nuk dua të më

Vijon nga faqe 10

thuhet që mos konsumo peshk. Është koha të ballafaqohemi me të."

IPEN është një rrjet i organizatave joqeveritare që punojnë në më shumë se 100 vende për të reduktuar dhe eliminuar dëmet ndaj shëndetit të njeriut dhe mjedisit nga kimikatet toksike.

www.ipen.org

Misioni i **Institutit të Kërkimit të Biodiversitetit** është të vlerësojë kërcënimet në rritje për kafshët e egra dhe ekosistemet nëpërmjet

hulumtimit bashkëpunues dhe të përdori gjetjet shkencore për të avancuar vetëdijen mjedisore dhe për të informuar vendimmarrësit.

www.briloan.org

Ju lutem për më tepër informacion referojuni raportit ndërkombëtarë:

http://ipen.org/sites/default/files/documents/update_18_sept_mercury-women-report-v1_5.pdf

Kuriozitete

A e dini arsye se pse konsumi dhe gjuetia e daterit (edhe në Shqipëri) është e ndaluar?

Gjuetia e daterit të detit (*Litophaga litophaga*) është e ndaluar që prej vitit 2006 në të gjithë komunitetin evropian. Edhe Shqipëria prej pak vitesh e ka të ndaluar jo vetëm gjuetinë e tij por edhe servirjen nga restorantet. Gjithsesi, jo në pak raste ka pasur gjueti të paligjshme dhe nuk kanë munguar organizatat në vend që ngrenë zërin vazhdimisht për këtë problematikë. Por cila është arsyeja e këtij vendimi? Daterit e detit rriten brenda shkëmbinjve dhe kanë një proces rritje ekstremisht të avashtë. Për të arritur gjatësinë 5 centimetra, atyre u duhen së paku 15 deri në 35 vite.

Përtej këtyre arsyeve dhe faktit se janë specie në zhdukje, ndalimi i gjuetisë së këtij molusku është bërë edhe për një shkak tjetër. Daterit rriten brenda shkëmbinjve dhe për nxjerrjen e tyre duhet shkatërruar shkëmbi. Ndaj, shumë

gjuetarë të tij përdorin mjete të ndryshme, nga çekiqët të eksplozivët.

Kjo mënyrë gjuetie ka sjellë shkatërrimin e sipërfaqeve të konsiderueshme të shkëmbinjve në rajonin e Mesdheut duke ndikuar në prishjen e biodiversitetit.

Burimi Web



NJOFTIME

5 Dhjetor - Dita Botërore e Tokës (bujqësore) / Dita Ndërkombëtare e Vullnetarizmit
11 Dhjetor - Dita Ndërkombëtare e Maleve

1 - Për të lexuar "Ditari i Natyrës" në vite...

<http://www.inca-al.org/index.php/sq/publikimet/ditari-i-natyres>

Udhëzime për të kontribuar në Ditarin e Natyrës

Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri mirëpret artikuj të ndryshëm të cilët ju dëshironi t'i publikoni në Ditarin e tij elektronik. Artikujt duhet të jenë jo më shumë se 200 - 250 fjalë. Ju lutemi të merrni në konsideratë këtë kërkesë, pasi interesi për të shpërndarë artikuj, lajme apo njoftime të ndryshme përmes Ditarit, mund të jetë i konsiderueshëm dhe ne do të përpiqemi për të siguruar hapësirë për të gjithë ju që dëshironi të kontribuoni. Redaksia ruan të drejtën për të shkurtuar apo modifikuar (jo tjetërsuar) tekstin nëse do të jetë e nevojshme.

Ju lutemi dërgoni një foto shoqëruese për artikullin tuaj dhe / ose web - link për referencë të mëtejshme.

Faleminderit për marrjen në konsideratë të këtyre udhëzimeve!

Grupimi "Të Shpëtojmë Arinjtë Shqiptarë"



Organizatrat Partnere të Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës



Botim i Institutit për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri / INCA
Redaksia: Nihat Dragoti; Ilirjan Qirjazi; Vilma Kadiu; Marinela Mitro

Adr.:Rruga "Islam Alla"
Pallati IVEA, Kati I
1001 Tirana-Albania

Tel.: +355 (0) 422 31 437
Fax: +355 (0) 422 31 437
E-mail: info@inca-al.org

www.inca-al.org
info@inca-al.org
www.facebook.com/inca.albania

INCA ALBANIA

